




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	01-4073/15
Data Datum Date	12.11.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.11.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-3441-15 për z.Bujar Muzaqi-Gjyqtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës-dega Podujevë, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë z.Muzaqi ka heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në një biznes privat.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-3441-15, për Zyrtarin e lartë, z.Bujar Muzaqi-Gjyqtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës-dega Podujevë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Muzaqi është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Muzaqi, është deklaruar se nuk ushton asnjë funksion menaxhues në atë ndërmarrje, por vetëm ka mbetë emri i tij i shkruar nga koha kur është regjistruar si biznes. Megjithatë ai është zotuar se brenda afatit ligjor, do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell një shkresë përcjellëse bashkë me shkresën zyrtare (DPK/DPKI-03-02-4005/15), nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se te biznesi Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar "Janissen-

Brass & Dannreuther Kosova” sh.p.k., z.Muzaqi tashmë është hequr nga e drejta e të qenurit person i autorizuar, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit



Hasan Preteni